



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:170326

Datë: 27.11.2024

Numri i dokumentit: 06522016

P.nr. 2024:170326

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm Samedin Cena, me zyrtarin ligjor Fatlind Kryeziu, në lëndën penale kundër të akuzuarve D. GJ. nga Gjakova dhe B. Th nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 e lidhur me nenin 31 të KPPRK-së, dhe E. K. nga Peja, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, të akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm sipas Aktakuzës me numër PP.II.nr.1132/23 të datës 25.03.2024 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 12.11.2024, në prezencën e Prokurorit të shtetit Uridia Caka, të akuzuarve D. GJ., B. Th dhe E. K., mbrojtësit të tij Av.Shaqir Vula, i angazhuar sipas detyres zyrtare, me datë 14.11.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 27.11.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit,

D. GJ., data e lindjes . . . në Gjakovë, ku edhe banon në rr “. . .”, nga i ati N dhe e ëma N e vajzërisë Th, i martuar, baba i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion metalpunues, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal.. . ., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

B. TH, data e lindjes . . . në Komunën e B. Currit, Republika e Shqipërisë, tani me vendbanim në fshatin . . ., rr “. . .” p.nr, Komuna e Gjakovës, nga i ati M dhe e ëma S e vajzërisë M, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion saldues, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal.. . ., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

dhe

E. K., data e lindjes . . . në Pejë, ku edhe banon në rr “ . . . , nga i ati Mifail dhe e ëma T e vajzërisë K, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal . . . , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Të akuzuarit D. GJ. dhe B. TH

JANË FAJTORË

Sepse me datë 29.07.2023, rreth orës 15:05 minuta, në Gjakovë në rr. “. . .”, me dashje dhe në bashkëkryerje i shkaktojnë lëndime trupore të dëmtuarit/pandehurit E. K. në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje të at çastshme e cila kishte ndodhur për shkak të tejkalimit me veturë nga ana e dëmtuarit, midis tyre fillon një përleshje fizike ashtu që fillimisht i pandehuri D. e hap derën e pasagjerit ia kap dorën të dëmtuarin dhe e godet me boka në fytyrë, i cili e nxjerr një thike dhe e godet të pandehurin në krahor ku menjëherë ndërhyjnë të pandehurit F. dhe B. duke e goditur te dëmtuarin me grushte dhe shuplakë në fytyrë dhe në kokë me ç‘rast i shkaktojnë lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkuara sipas ekspertizës mjeko ligjore të datës 04.09.2023.

- Me çka kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 prg. 1 nënprg.1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,7,17,38,39,40,46,48,49, 69,70 të KPRK-së dhe neneve 242, 358, 364 e 365 të KPPRK-së, të akuzuarve ju shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i përcakohet:

- I. Të akuzuarit D. GJ. Dënimi me burg në kohëzgjatje prej njëqind (100) ditësh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
- II. Të akuzuarit B. Th. Dënimi me burg në kohëzgjatje prej njëqind (100) ditësh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

- III. Gjykata mund ta revokon dënimin me kusht me burgim nëse të dënuarit gjatë kohës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti duke filluar nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë kryejnë një apo më shumë vepra penale.
- IV. Obligohen të akuzuarit D. GJ. dhe B. Th., secili veç e veç që të paguajnë shpenzimet procedurale sipas përlogaritjes përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzet e pesë Euro) si dhe në bazë të nenit 36 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 € (njëzet Euro), në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I akuzuari E. K.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me dashje dhe me përdorimin e mjetit të rrezikshëm që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit/pandehurit D. GJ., në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje të at çastshme pasi i dëmtuari D. e sulmon me boksa të pandehurin/dëmtuarin, i njëjti e nxjerr një thike e godit të dëmtuarin D. në anën e majtë të krahorit, me ç'rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkuara sipas ekspertizës mjeko ligjore të dt.04.09.2023.

- Me çka ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafin.1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,7,17,38,39,40,46,48,49, 69,70 të KPRK-së dhe neneve 242, 358, 364 e 365 të KPPRK-së, i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i përcaktohet:

- I. Dënimi me burg në kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditësh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

- II. Gjykata mund ta revokon dënimin me kusht me burgim nëse i dënuari gjatë kohës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti duke filluar nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë kryen një apo më shumë vepra penale.
- III. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzet e pesë Euro) si dhe në bazë të nenit 36 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 € (njëzet Euro), në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Konform nenit 276 të KPPRK-së, konfiskohet brisku (thika) si mjet i kryerjes së veprës penale i sekuestruar me datë 29.07.2023.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën me numër PP.II.nr.1132/23 të datës 25.03.2024, kundër të akuzuarve D. GJ. nga Gjakova dhe B. Th nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nën par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe E. K.t nga Peja për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që të njejtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm me datë 12.11.2024 ka mbajtur shqyrtimin fillestar për të akuzuarit D. GJ., B. Th dhe E. K., për veprat penale për të cilat akuzohen sipas aktakuzës së lartcekur, në të cilin shqyrtim ishin prezent Prokurori i Shtetit Uridia Caka, të akuzuarit D. GJ., B. Th dhe E. K. dhe mbrojtësi i tij avokat Shaqir Vula i angazhuar sipas detyres zyrtare.

I akuzuari D. GJ. pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për favoret dhe pasojat e pranimin të fajësisë, lidhur me fajësinë deklaroj se e pranoj fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, duke shtuar se ka qenë reagim momental që ka ardhur si pasojë e kaosit në komunikacion, me palët e dëmtuara jemi pajtuar mes veti dhe nuk kemi asnjë problem dhe më vjen shumë keq për rastin që ka ndodhur.

I akuzuari B. Th pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për favoret dhe pasojat e pranimin të fajësisë, lidhur me fajësinë deklaroj se e pranoj fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, më vjen keq për rastin që ka ndodhur ka qenë momentale dhe me palën e dëmtuar i kemi rregulluar raportet.

I akuzuari E. K. pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit deklaroi se pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë, lidhur me fajësinë deklaroi se e pranoi fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, ka shtuar se ka ndodh rastësisht për shkak të kolonës së krijuar në komunikacion, pas 2 dite jemi takuar dhe jemi pajtuar me palën e dëmtuar dhe jam penduar për atë që ka ndodhur, andaj më vjen keq për këto veprime.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. K., avokat Shaqir Vula lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se e mbështes deklarin e të akuzuarit E., pastaj besoj në deklarin e tij se është penduar thellë për ngjarjen që ka ndodhur, ka qenë e momentit dhe duke u mbështetur në deklarin e të akuzuarve se këtë moment e kanë kaluar dhe nuk do ta përsërisin më, për këtë jam bindur edhe vet para fillimit të kësaj seance ku të njëjtit i kishin marrëdhëniet e rregulluara, i akuzuari E. është i vetë punësuar dhe i vetmi kontribues në familjen e tij dhe nuk është një person i njohur për rrethin ku jeton si problematik dhe gjitha këto t'i keni parasysh gjatë marrjes së vendimit.

Prokurori i Shtetit Uridia Caka lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në shqyrtim fillestar ka deklaruar se nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarve meqenëse të njëjtit pranimin e fajësisë e kanë bërë në mënyrë vullnetare pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ndërsa i akuzuari E. edhe pas konsultimeve me mbrojtësin e tij, si dhe duke pasur parasysh se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban kjo aktakuzë, i propozoj gjykatës që ta miratoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe të njëjtit t'i shpall fajtor, t'i dënoj sipas ligjit dhe t'i obligoj njëkohësisht në kompensimin e shpenzimeve të procedurës. Si dhe pajtim me nenin 92 të KPRK lidhur me nenin 238 par 1 nën par 1.9 dhe nenin 270 par 1 të KPPRK-së si mjet i kryerjes se veprës penale të konfiskohet një brisik me ngjyrë të zeze dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit i njëjti të shkatërrohet, ndërsa propozoj që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për këta të akuzuar si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, kërkim falja ndaj njëri tjetrit, ndërsa si rrethanë rënduese të merret dashja e lartë në kryerjen e veprave penale si dhe pesha e veprave penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtari i çështjes në shqyrtim fillestar pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga të akuzuarit D. GJ. nga Gjakova dhe B. Th nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nën par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe E. K. nga Peja për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, nga se ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së.

Gjatë pranimit të fajësisë gjykata ka fituar bindjen se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale, që ju vihet në barrë dhe është bindur se pranimin

e kanë bërë në baza vullnetare, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana gjykatës për pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë si dhe duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarve.

Meqenëse të akuzuarit kanë pranuar fajësinë gjykata ka konsideruar se në këtë fazë të procedurës nuk do të ketë procedurë të provave e as fjalë përfundimtare.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjykata ka vërtetuar këto gjendje faktike se:

Të akuzuarit D. GJ. dhe B. Th kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nën par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I të këtij Aktgjykimi, ashtu që me datë 29.07.2023, rreth orës 15:05 minuta, në Gjakovë në rr. “Sylejman Avdyli”, me dashje dhe në bashkëkryerje i shkaktojnë lëndime trupore të dëmtuarit/pandehurit E. K. në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje të at çastshme e cila kishte ndodhur për shkak të tejkalimit me veturë nga ana e dëmtuarit, midis tyre fillon një përleshje fizike ashtu që fillimisht i pandehuri D. e hap derën e pasagjerit ia kap dorën të dëmtuarin dhe e godet me boksa në fytyrë, i cili e nxjerr një thikë dhe e godet të pandehurin në krahor ku menjëherë ndërhyjnë të pandehurit F. dhe B. duke e goditur të dëmtuarin me grushte dhe shuplakë në fytyrë dhe në kokë me ç’rast i shkaktojnë lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruara sipas ekspertizës mjeko ligjore të datës 04.09.2023.

I akuzuari E. K. ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin II të këtij Aktgjykimi, ashtu që me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me dashje dhe me përdorimin e mjetit të rrezikshëm që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit/pandehurit D. GJ., në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje të at çastshme pasi i dëmtuari D. e sulmon me boksa të pandehurin/dëmtuarin, i njëjti e nxjerr një thikë e godet të dëmtuarin D. në anën e majtë të krahorit, me ç’rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruara sipas ekspertizës mjeko ligjore të datës 04.09.2023.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi edhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe atë: Deklarata e të pandehurit/dëmtuarit E. K. dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë me datë 18.06.2024, Deklarata e të pandehurit/dëmtuarit D. GJ. dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë me datë 19.06.2024, Deklarata e të pandehurit B. Th dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë me datë 19.06.2024, Akt ekspertiza mjeko-ligjore me numër Gja-367/23 e datës 04.09.2023 përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor Dr. Musa Gashi, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me numër të rastit 2023-EA-1018 i datës 29.07.2023, Foto albumi nga shkresat e lëndës, Një brisk me ngjyrë të zezë me nr. të rastit 2023-EA-1018.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 185 paragrafi 1 nën par 1.4 të KPRK-së, është parashikuar se veprën penale Lëndim i lehtë trupor e kryen *“Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”*.

Ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni parashihet *“Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”*.

Ndërsa në nenin 31 të KPRK-së është parashikuar Bashkëkryeja si një nga format e bashkpunimit në kryerjen e veprës penale në të cilën citohet se *“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale”*

5. Vendimi

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, si dhe me vetë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, gjyqtari i çështjes të akuzuarit D. GJ., B. Th dhe E. K. i ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilën ngarkohet ngase në veprimet e të akuzuarve të përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nën par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, e bazuar në këtë ka vendosur që të akuzuarit t'i gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke ju vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parapara nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikonin në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit.

Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin D. GJ. Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit pendimin e thellë për veprën penale të kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, sjelljen e tij korrekte në gjykatë. Ndërsa si rrethana posaçërisht

lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë dhe kërkim faljen ndaj njeri tjetrit. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka vlerësuar peshën e veprës penale dhe intensitetin e rrezikimit shoqëror që paraqesin këto vepra penale.

Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin B. Th. Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit pendimin e thellë për veprën penale të kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, sjelljen e tij korrekte në gjykatë dhe faktin se është hera e parë që bie ndesh me ligjin. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë dhe kërkim faljen ndaj njeri tjetrit. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka vlerësuar peshën e veprës penale dhe intensitetin e rrezikimit shoqëror që paraqesin këto vepra penale.

Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin E. K. Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit pendimin e thellë për veprën penale të kryer, faktin se është mbajtës i familjes, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, sjelljen e tij korrekte në gjykatë. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë dhe kërkim faljen ndaj njëri tjetrit dhe faktin se është hera e parë që bie ndesh me ligjin. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka vlerësuar peshën e veprës penale dhe intensitetin e rrezikimit shoqëror që paraqesin këto vepra penale.

Gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tyre dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7 . Vendimi per konfiskim

Vendimi për konfiskim të briskut (thikë) me ngjyrë të zezë është marrë konform nenit 276 të KPPRK-së, si mjet i kryerjes së veprës penale e konfiksuar nga i akuzuari E. K. me datë 29.07.2023 sipas Vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve.

8 .Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marrë konform nenit 452 paragrafi 1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.2024:170326, më datë 27.11.2024

Zyrtari Ligjor
Fatlind Kryeziu

Gjyqtari
Samedin Cena

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.